

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit shtator, 2025

Takim pune mes autoriteteve antikorrupsion të Shqipërisë dhe Kosovës

16.09.2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit të Kosovës zhvilluan një takim pune njëditor në Tiranë. Krerët e të dy institucioneve, z. Insidor Rexhepi dhe z. Yll Buleshkaj, së bashku me delegacionet shoqëruese, diskutuan mbi mundësitë e forcimit të bashkëpunimit ndërinstucional. Në qendër të diskutimeve ishin shkëmbimi i përvojave dhe mekanizmat e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies, si dhe instrumentet parandalues të korrupsionit, përfshirë etikën, konfliktin e interesit dhe sinjalizimin. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit konfirmoi gatishmërinë për të intensifikuar partneritetin me institucionin homolog të Kosovës, duke synuar nisma të përbashkëta në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm në konsolidimin e marrëdhënieve dhe hap rrugën për projekte të reja bashkëpunimi, ku integriteti në sektorin publik mbetet një parim themelor.



Vlerësimi i riskut të integritetit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

29.09.2025: Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit nisën procesin e konsultimit publik për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në sektorin e pronave. Ky proces përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mekanizmave antikorrupsion dhe do të shërbejë si bazë për hartimin e Planit të Integritetit 2025 - 2027, i cili synon parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e transparencës në sektorin e pronës dhe të të drejtave pronësore. Me pjesëmarrjen e posaçme të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, u mbajt një tryezë e hapur konsultimi me temë “Vlerësimi i Riskut të Integritetit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”, në auditorin e përfaqësuesve drejtues dhe ekspertë të institucioneve kombëtare publike, sektorit privat, profesione të lira dhe shoqërisë civile. Të pranishmit dhanë mendime dhe sugjerime mbi masat me ndërhyrje për garantimin e integritetit dhe llogaridhënies për çdo hallkë e proces pune në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Në vijim, pritet që konsultimi të finalizohet me miratimin e një Plani Integriteti, që do të adoptojë kuadrin e brendshëm rregullator, ngritjen e kapaciteteve institucionale ku qëllimi është përmirësimi i perceptimit të publikut ndaj problematikave të pronave. Me miratimin e Planit të Integritetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës do të shënjohej realizimi i një prej angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të Agjendës së Reformave dhe Planit të Rritjes të Bashkimit European, duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes, forcimin e integritetit institucional dhe avancimin e vendit në rrugën e integritetit evropian.

Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ përgjatë muajit shtator 2025

1-30.09.2025: Gjatë muajit shtator 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka konkluduar 11 raporte përfundimtare për Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtoritë Rajonale të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, mbi bazën e analizës së plotë të fakteve dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ. Në relevancë me natyrën e shkeljes së konstatuar, ndikimin që ajo ka sjellë në funksionimin e institucionit si dhe shkallën e përgjegjësisë individuale të punonjësve, janë propozuar 26 masa disiplinore për titullarë, ish-titullarë dhe punonjës të institucioneve ku është kryer hetimi. Gjithashtu, nisur nga roli i rëndësishëm i DPAK për sa i përket parandalimit të korrupsionit, janë propozuar rekomandime, me qëllim përmirësimin e qëndrueshëm të institucionit, kapaciteteve menaxhuese, ligjore, dhe teknike në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Në këtë kontekst, janë propozuar 54 rekomandime të cilat në 32 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe në 22 raste adresojnë çështje me natyrë organizative si: menaxhimi i përditshëm, procedurat e brendshme të institucionit, si dhe rekomandime të cilat adresojnë çështje të natyrës së përmirësimit të bashkëpunimit institucional.



Edicioni i 7-të i Javës së Integritetit: Nisin përgatitjet

26.09.2025: Jemi në prag të fushatës vjetore të ndërgjegjësimit kundër korrupsionit “Java e Integritetit” edicioni VII. Në dhjetor 2025 do të zhvillohet java e aktiviteteve kundër korrupsionit, dhe për këtë qëllim partnerët e sektorit publik, privat, shoqëri civile dhe të huaj që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri, u mbledhën bashkë për ndarjen e ideve dhe propozimeve. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit priten të kenë një rol aktiv me rëndësi të ndërgjegjësimit qytetar dhe përfshirjes së të rinjve në promovimin e transparencës dhe integritetit. Ndër aktivitetet e propozuara për këtë edicion nga autoriteti antikorrupsion përmenden: forume debati me studentë dhe të rinj mbi temën e integritetit dhe lidershit etik; ekspozitë sensibilizuese me punime artistike të nxënësve mbi temën “*Integriteti në jetën e përditshme*”, sfida digjitale në rrjetet sociale për përhapjen e mesazheve kryesore kundër korrupsionit; tryeza institucionale me përfaqësues nga sektori publik dhe privat për shkëmbimin e praktikave të mira mbi qeverisjen e ndershme. Dita e Hapur e Integritetit me pjesëmarrje të qytetarëve do të jetë një risi e fushatës vjetore 2025, me qëllimin njohjen nga afër me punën e institucioneve kundër korrupsionit.

Trajnim mbi etikën dhe mekanizmat antikorrupsion për administratën publike

4 & 9.09.2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit së bashku me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike zhvilloi trajnimin me temë “Forcimi i llogaridhënies institucionale, përmes etikës, informimit dhe mekanizmave antikorrupsion”. Kurrikula u organizua në dy sesione, e ndjekur nga 15 pjesëmarrës nga disa ministri të linjës dhe autoritete të tjera qendrore. Trajnimi u udhëhoq nga ekspertë të fushës së antikorrupsionit të Shkollës Shqiptare të Administatës Publike dhe kishte si synim rritjen e njohurive të punonjësve të rinj të administratës publike mbi mekanizmat kyç të integritetit. Diskutimet u fokusuan tek etika profesionale, parimet e integritetit, sinjalizimi i shkeljeve, lobimi dhe parandalimi i konfliktit të interesit, elementë të domosdoshëm për ndërtimin e një administrate transparente dhe llogaridhënëse. Trajnimi synon të forcojë kulturën e integritetit në shërbimin publik dhe të garantojë që edhe stafi i ri të jetë i pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kontribuar në një administratë më të ndershme, efikase dhe në shërbim të qytetarëve. Trajnimi siguroi gjithashtu zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, në kuadër të rritjes së kapaciteteve institucionale teknike në sektorin publik.

